

## VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

### **Vendimi Nr. 2022-016**

**Data: 27.02.2022**

#### **Workshopi për trajner me Hrvoje Zmajic**

Bordi me shumicë votash ka aprovuar organizimin e Workoshpit për trajner të tenisit me ekspertin ndërkombëtar Hrvoje Zmajic.

Seminari do zgjasë pesë (5) ditë nga data 25-29 Prill, ndërkaq asistentë të Hrvoje do të jenë trajnerët Arian Ibrahimimi dhe Meldin Mustafi.

Të gjithë pjesëmarrësit do të vijojnë seminarin pa tarifë, ndërkohë që FTK do të mbulojë shpenzimet e drekës dhe udhëtimit.

FTK në bashkëpunim me MKRS do të mbulojë po ashtu të gjitha shpenzimet e ekspertit, si mëditje, transport, akomodim.

### **Vendimi Nr. 2022-K02**

#### **Projekti Tennis Festival**

Kryetari Hadërgjonaj merr vendim fillimin e aktivitetit Tennis Festival, i cili do të organizohet në 13 komuna të Kosovës, të cilët do të zgjasin nga 1 ditë.

Për organizimin e këtij aktiviteti do të angazhohen nga 1 kordinator, 4 deri 6 asistentë dhe 1 fotograf për secilën Komunë të cilët do të kompensohen si në vijim:

- Kordinatorët | 200 euro për organizim të aktivitetit
- Asistentët | 50 euro për ndihmë gjatë aktivitetit
- Fotografët | 50 euro për ditë

FTK do të mbulojë edhe shpenzimet e transportit për trajnerët sipas rregullores 03, dhe fëmijëve që do të udhëtojnë për pjesëmarrje në aktivitet deri në maksimum 100 euro, përmes autobusëve që do të kontraktohen.

### **Vendimi Nr. 2022-017**

**Data: 04.05.2022**

#### **Dhënia në shfrytëzim e fushave të tenisit në Taukbahqe**

Bordi me shumicë votash merr vendim që fushat e tenisit në Taukbahqe të jepen në shfrytëzim tek klubet KT Prishtina dhe KT DielliX.

Dy terrene do të jepen në shfrytëzim të klubit Prishtina dhe dy terrene tek klubi DielliX, sipas marrëveshjeve dhe kushteve të nënshkruara mes palëve.

**Vendimi 2022-K03**

**18.05.2022**

**European Juniors Championships 2022**

Bazuar në vendimin nr. 2019-024 për përzgjedhjen e tenistëve në gara të përfaqësuesve, Kryetari Hadërgjonaj merr vendim që për European Juniors Championships 2022 të propozohet vetëm tenisten Vesa Gjinaj e cila plotëson kriterin në fuqi rreth rankingut për grupmoshën U18.

EJCH 2022 për U18 këtë vit mbahet në Klosters, Zvicër.

**Vendimi Nr. 2022-018**

**Data:27.05.2022**

**Përkrahja e tenistëve në gara të cilët nuk janë në ranglistën e Kosovës.**

Bordi me shumicë votash merr vendim që tenistët me potencial të lartë të cilët përfaqësojnë Kosovën në garat ndërkombëtare të përfitojnë nga rimbursimi i shpenzimeve sipas pikës 8.10 të rregullores 03 për financa, procedura dhe rregulla, edhe nëse nuk janë të ranguar në ranglistën e Kosovës.

**Vendimi 2022-K04**

**27.05.2022**

**Përgatitjet për Lojërat Mesdhetare Oran 2022**

Kryetari Hadërgjonaj miraton propozimin e selektorit për përgatitjet e tenistëve Vesa Gjinaj dhe Vullnet Tashi për Lojërat Mesdhetare Oran 2022, pas ftesës së pranuar nga KOK për organizmin e ushtrimeve për pjesëmarrësit.

Tenistët do të jenë pjesë e ushtrimeve intensive 1 javore, nga data 05-11 qershor, që do të zhvillohen në Zvicër.

KOK do të mbuloj disa nga shpenzimet e këtij kampi në vlerë 700 EUR për person, ndërsa FTK do të mbulojë shpenzimet tjera të aktivitetit.